



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 147, datë 08.04.2021**

**PËR**  
**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR**  
**PERIUDHËN E VLERËSIMIT VITI 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit viti 2019”, i hartuar nga relatore z. Erjon Muharremaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit viti 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT  
I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL  
TË GJYQTARES

Tiranë më 08.04.2021

TË DHËNAT E GJYQTARES

Emri: \_\_\_\_\_

Mbiemri: \_\_\_\_\_

Datëlindja: \_\_\_\_\_

Vendbanimi: Tiranë

Adresa e e-mailit zyrtar: \_\_\_\_\_

Adresa e e-mailit privat: \_\_\_\_\_

Numër telefoni: \_\_\_\_\_

Gjykata: \_\_\_\_\_

Funksioni: \_\_\_\_\_

Seksioni: Nuk ka

Vlerësimi i mëparshëm: Periudha e vlerësimit 2007-2009 / “ Shumë mirë”

Masa disiplinore: Nuk ka

Periudha e vlerësimit : 01 Janar 2019 – 31 Dhjetor 2019

VLERËSUES

Relator: Erjon Muharremaj

Nëpunës përgjegjës për vlerësimin: Zeta Tërpollari

## QËLLIMI

*Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, ka për qëllim vlerësimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarës në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale të saj për periudhën e vlerësimit 1 janar 2019 – 31 dhjetor 2019. Kjo shkallë aftësie ndiqet nga një pikëzim, mbi të cilin përcaktohet niveli i vlerësimit për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit si dhe ai i përgjithshëm, të cilët i propozohen për miratim Mbledhjes Plenare.*

*Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës hartohet bazuar në parashikimet e neneve 68, 89 e vijues dhe 93 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, nr. 264, datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit” dhe vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”.*

*Me qëllim përcaktimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarës për çdo tregues, aspekt dhe kriter vlerësimi, relatori bën analizë të integruar të të gjitha të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit, ashtu sikundër ato përshkruhen dhe detajohen në Raportin Analitik të përgatitur nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.*

---

## ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI.

### 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

#### 1.A Njohuritë ligjore.

*1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja në bazë të kategorisë së çështjes (*penale themeli ose kërkesa në fazën e hetimeve paraprake*), përshkruan në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, faktet e çështjes në përputhje me provat e administruara. Në dy raste

gjqtarja nuk ndalet në përshkrimin e fakteve të çështjes, duke qenë se gjyqtarja ka përshkruar vetëm analizën në lidhje me kualifikimin juridik të faktit penal me mendim ndryshe nga shumica (*mendimi i pakicës në vendimet nr.14, datë 13.02.2019 dhe nr.15, datë 15.02.2019*).

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi menjëherë pas paraqitjes së fakteve të çështjes dhe përshkrimit shkurtimisht të rrethanave procedurale të çështjes, në lidhje me kërkesën objekt ankimi dhe shqyrtimin në apel.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet e vëzhguara rezultojnë se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke evidentuar dhe herë pas here duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural, të Kodit të Procedurës Penal, Kodit të Procedurës Civile,<sup>1</sup> të Kodit Penal dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjen konkrete.

Sa i përket ligjit procedural, gjyqtarja ka referuar dhe cituar si pjesë të arsytimit të vendimit, nenin 425 të K.Pr.Penale, të ndryshuar me ligjin nr.35/2017, në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel, referuar shkaqeve të ankimit të pandehurit. Gjyqtarja ka referuar dhe cituar nenet 151 dhe 152 të K.Pr.Penale në lidhje me vlerën dhe fuqinë provuese të provave të administruara, citon dispozitat penale: nenin 405 të K.Pr.Penale në lidhje me mënyrën e procedimit të çështjes. (*vendimi nr. 70, datë 17.10.2019*); nenin 201/a të K.Pr.Penale, të ndryshuar, në lidhje me nenin 407 pika 1 dhe 2 të K.Pr.Penale, gjatë analizimit dhe vlerësimit që i bëhet nëse ndaj vendimit të shkallës së parë për marrjen me detyrim të kampioneve biologjike, lejohet apo jo të bëhet ankim në apel; nenin 112 pika 1 dhe 2 të K.Pr.Penale në lidhje me nenin 201/a të K.Pr.Penale, në funksion të përcaktimit të disponimit të shkallës së parë, si dhe për të përforcuar argumentimin e vendimit objekt ankimi, si një vendim/urdhër i paankimueshëm (*vendimi nr. 222, datë 06.12.2019*). Referohen dhe citohen nenet 375 dhe 425/3 të K.Pr.Penale në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të çështjes, sipas mendimit të pakicës, me konkluzionet e prishjes së vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë (*mendimi i pakicës në vendimin nr. 14 datë 13.02.2019*); nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale, në lidhje me ekzistencën e kushteve (të përgjithshme dhe të posaçme) dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit gjatë analizimit dhe vlerësimit që i bëhet caktimit të masës së sigurimit ndaj personit nën hetim (*vendimi nr. 57, datë 08.10.2019*), etj.

Sa i përket dispozitave të ligjit material të zbatueshëm, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar dispozitat e ligjit material si më poshtë:

- nenet 333/a, 283/a të K.Penal dhe neni 28 pika 4 i K.Penal, lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, për kryerjen e veprës penale të cilat i atribuohen personit nën hetim deri në këtë fazë të procedimit penal (*vendimi nr. 57, datë 08.10.2019*);
- nenet 28/4 dhe 334 të K.Penal, për të sqaruar formën e veçantë të bashkëpunimit në funksion të argumentimit ndryshe nga shumica për kualifikimin juridik të faktit penal për të cilën akuzohet i pandehuri (*mendim i pakicës, në vendimin nr. 14 datë 13.02.2019*);

---

<sup>1</sup> Vendimi civil nr. 200, datë 27.03.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë

- nenet 47 dhe 23 të K.Penal, në funksion të individualizimit të dënimit për të dy të pandehurit, e individualizuar kjo në raport me pjesëmarrjen dhe rolin që ata kanë luajtur në ardhjen e pasojës, rrethanave lehtësuese dhe rënduese për secilin, si dhe shkallës së afërsisë së ardhjes së pasojës (*vendimi nr. 66, datë 10.10.2019*);
- nenet 128/b paragrafi i 1, neni 114 paragrafi i 1 dhe neni 113 paragrafi i 2 të K.Penal, në lidhje me kualifikimin juridik të faktit penal për të përcaktuar kompetencën lëndore të shqyrtimit të çështjes (*vendimi nr. 15, datë 15.02.2019*);
- nenet 178, 38 dhe 79 të Kodit Rrugor, që referojnë tek rasti konkret për të analizuar anën objektive të veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i K.Penal, që i atribuohet të pandehurit, duke qenë se neni 290 i K.Penal është një dispozitë “banket”. (*vendimi nr. 160, datë 10.04.2019*).

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet e vëzhguara rezulton se në vendimin nr. 70, datë 17.10.2019, gjyqtarja interpreton konfliktin e ligjeve në rastin konkret, nenin 425 paragrafi i parë dhe i tretë, duke theksuar se ndaj të drejtës që ka Gjykata e Apelit të bëjë ndryshimin e cilësimit juridik, prevalon në rastin konkret parimi *no reformatio in peius* - mosrëndimi i pozitës së të pandehurit, duke qenë se në rastin konkret ankues është vetëm i pandehuri.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe bën përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

#### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se gjyqtarja në përputhje me rrethanat procedurale dhe faktike të çështjes objekt shqyrtimi si dhe shkaqeve të ngritura në ankim, referon, citon dhe interpreton norma të ligjit procedural dhe material të zbatueshëm mbi faktet e çështjes, në shërbim të analizës ligjore, me qëllim mbështetjen e konkluzioneve të arritura lidhur me zbatimin e tyre në zgjidhjen e çështjes.

Konkretisht, në lidhje me normat procedurale, gjyqtarja ka interpretuar normat procedurale në disa raste, si më poshtë:

- Në kuadër të përcaktimit nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, gjyqtarja nuk ndalet vetëm në trajtimin teorik të interpretimit të dispozitave procedurale, nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale, por i interpreton këto dispozita në përputhje me provat dhe rrethanat e çështjes (*vendimi nr. 57, datë 08.10.2019*);
- Interpreton nenin 425 të K.Pr.Penale, në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Apel, referuar ndryshimeve të K.Pr.Penale me ligjin nr. 35/2017 (*vendimi nr. 70, datë 17.10.2019*);

- Gjyqtarja interpreton nenin 201/a të K.Pr.Penale, i ndryshuar, në lidhje me nenin 407 pika 1 dhe 2 e K.Pr.Penale, gjatë analizimit dhe vlerësimit që i bëhet nëse ndaj vendimit (*urdhër sipas përcaktimit të bërë nga gjykata e apelit*) të shkallës së parë për marrjen me detyrim të kampionëve biologjikë lejohet të bëhet ankim në apel. Gjyqtarja interpreton nenin 112 pikat 1 dhe 2 të K.Pr.Penale për mënyrat e disponimit të gjykatës në lidhje me nenin 201/a të K.Pr.Penale, në funksion të përcaktimit të disponimit të shkallës së parë (*nëse jemi para një vendimi apo një urdhri*), si dhe për të përforcuar konkluzionin e arritur se ndaj disponimit të gjykatës së shkallës së parë nuk lejohet të bëhet ankim, jo vetëm pasi në rastin konkret disponimi i gjykatës përcaktohet si urdhër, por edhe për shkak të faktit se nuk parashikohet në mënyrë autonome e drejta e ankimit në këtë dispozitë. Interpretimi i nenit 201/a të K.Pr. Penale, bëhet jo vetëm duke e parë atë në kuptimin literal të saj, por edhe në vështrim krahasues dhe sistematik me dispozitat e tjera që kanë lidhje me njëra-tjetrën, si me dispozitat procedurale në të cilën parashikohen mënyrat e disponimit të gjykatës me urdhër dhe vendime, ashtu edhe me dispozitat në të cilat parashikohet e drejta e ankimit (*vendimi nr. 222, datë 06.12.2019*);
- Gjyqtarja interpreton kuptimin dhe zbatimin e nenit 128/a të K.Pr.Penale në funksion të zgjidhjes së çështjes, duke evidentuar faktin se kualifikimi i gabuar i faktit penal, si nga gjyqtari i seancës paraprake, ashtu edhe nga gjykata e themelit, ka sjellë për pasojë pavlefshmëri absolute të dispozitave për thirrjen e të pandehurit, si dhe dispozitat që kanë lidhje me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale (*mendimi i pakicës në vendimin nr. 14, datë 13.02.2019*);
- Gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Apel, referuar ndryshimeve të K.Pr.Penale, me ligjin nr. 35/2017. Ajo interpreton nenet 375 pika 2 dhe 405 të K.Pr.Penale, të ndryshuar, referuar pretendimit të bërë nga njëri prej të pandehurve në lidhje me kualifikimin e faktit penal, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt në ndryshimin e kualifikimit të faktit penal edhe pse është proceduar sipas rrit të gjykimit të shkurtuar (*vendimi 66, datë 10.10.2019*);
- Gjyqtarja interpreton nenin 75/a të K.Pr.Penale, të ndryshuar, në lidhje organike me nenin 285 të K.Pr.Penale (*dispozita tranzitore*), në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes objekt ankimi (*vendimi 15, datë 15.02.2019*);
- Gjyqtarja interpreton nenin 463 të K.Pr.Civile në lidhje me efektet që ka heqja dorë e palës ankuese nga ankimi, duke përcaktuar se është e drejtë e palës ankuese, që në çdo fazë të gjykimit të çështjes në apel të heqë dorë nga ankimi.

Në lidhje me dispozitat materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, në vendimet e analizuara, rezulton se gjyqtarja, përveç citimit, ndalet edhe në interpretimin ligjor të tyre dhe më pas vijon me aplikimin mbi faktet konkrete, për të mbështetur konkluzionet e arritura lidhur me çështjen. Konkretisht, rezulton të jenë interpretuar dispozitat ligjore materiale si më poshtë:

- Në funksion të cilësimit juridik të veprës penale të “Grupit të Strukturuar kriminal”, gjyqtarja ndalet fillimisht në disa konsiderata të përgjithshme dhe në interpretimin teorik të saj, duke e përputhur në vijim me provat dhe rrethanat e fakteve, për të konkluduar se gjykata e shkallës së parë e ka cilësuar drejt faktin penal. Gjyqtarja, në cilësimin e veprës penale të trafikimit të lëndëve narkotike në formën e veçantë të bashkëpunimit, ndalet edhe në interpretimin e nenit 28/a të K.Penal, në përputhje me rrethanat e fakteve, duke i bërë analizën çdo prove të lejuar dhe të marrë në shqyrtim. Interpreton nenet 47 dhe 334/1 të

K.Penal, në lidhje me individualizimin e dënimit për të pandehurin për të konkluduar se: referuar provave dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale, rrezikshmërisë së veprave penale të kryera dhe rrezikshmërisë së autorit, nuk ekzistojnë shkaqe të paraqitura nga mbrojtja për lehtësimin e dënimit. Interpreton dispozitat materiale të K.Penal (*neni 257/a/2 i K.Penal*) dhe ato të ligjit të posaçëm që të referon dispozita penale (*që ka lidhje organike me të, ligji nr. 9049 datë 10.04.2003, i ndryshuar*) dhe duke ia përputhur interpretimit teorik të dispozitave të sipërcituara faktet dhe provat objekt shqyrtimi, gjyqtarja konkludon në cilësimin juridik të veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit në lidhje me këtë fakt penal (*vendimi nr. 70, datë 17.10.2019*);

- Gjyqtarja interpreton kuptimin e neneve 28 dhe 334 të K.Penal, duke evidentuar edhe dallimin ndërmjet bashkëpunimit të thjeshtë dhe atij të veçantë, në funksion të argumentimit se kualifikimi juridik i faktit penal është i gabuar, pasi i pandehuri e ka kryer veprën penale në formën e bashkëpunimit të veçantë dhe jo në formën e bashkëpunimit të thjeshtë, si rrethanë cilësuese e dispozitës (*neni 283/a/2 i K.Penal*). (*mendimi i pakicës, në vendimin nr. 14, datë 13.02.2019*);
- Gjyqtarja, me qëllim analizimin e elementeve të figurës së veprës penale, anës objektive dhe asaj subjektive, interpreton në përputhje me provat jo vetëm nenin 290 të K.Pr.Penale, por edhe dispozitat materiale të ligjeve të posaçme që kanë lidhje me rastin konkret. Duke qenë se neni 290 i K.Penal është një dispozitë “*blanket*”, gjyqtarja interpreton dispozitat materiale në ligjet e posaçme (*nenet 178, 38, 79 të Kodit Rrugor*) që referojnë tek rasti konkret, për të analizuar anën objektive të veprës penale që i atribuohet (*vendimi nr. 160, datë 10.04.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë*).

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, evidentohet se gjyqtarja në çdo rast ka respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor, si parimi *no reformatio in peius* - mosrëndimi i pozitës së të pandehurit, *parimin e ligjshmërisë*, nenin 2 të K.Penal, sipas të cilit askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është parashikuar në ligj si krim apo si kundërvajtje penale, sanksionuar gjithashtu edhe në nenin 29 pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës dhe nenin 7 të KEDNJ-së (*vendimi nr. 70, datë 17.10.2019*).

Gjithashtu, janë zbatuar edhe parime të tjera të procesit penal, të tilla si: parimi *iura novit curia* - gjykata e njej ligjin - në lidhje me të drejtën e Gjykatës së Apelit për ndryshimin juridik të faktit penal; parimi *Ubi lex voluit dixit, ubi noluit tacuit* – aty ku ligji ka dashur ka folur, atje ku nuk ka dashur, ka heshtur; parimi *tantum devolutum quantum appellatum* – shqyrtimi i çështjes në apel brenda shkaqeve të ngritura në ankim.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën, në shumicën e vendimeve të analizuar rezultoi se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, si më poshtë:

- Në lidhje me ekzistencën ose jo të kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit, gjyqtarja i referohet Kushtetutës së RSH-së dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Lartë në vendimet e saj unifikues (*vendimi nr. 7, datë 14.10.2011 i Gjykatës së Lartë*), në atë të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, duke cituar edhe jurisprudencën përkatëse të kësaj gjykate në çështjen *Vafiadis vs Greqisë apo Levriere vs Belgjikës, Pantano vs Italisë* etj., (*vendimi 57 datë 08.10.2019*);

- Gjyqtarja citon jurisprudencën e GJEDNJ-së, konkretisht vendimet *Drassich vs Italisë* dhe *Pelissier dhe Sassi vs Francës* për një gjykim të drejtë, të sanksionuar nga paragrafi 1 i nenit 6 të Konventës në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të çështjes, sipas mendimit të pakicës për prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rigjykim Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (mendimi i pakicës në vendimin nr. 14, datë 13.02.2019);
- Në funksion të konkludimit se i pandehuri ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 333/a/2 i K.Penal, në formën e një bashkëpunimi të veçantë kriminal, gjyqtarja i referohet edhe jurisprudencës unifikuese (vendimit nr. 4 datë 15.04.2011 të Gjykatës së Lartë), si dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope (vendimi nr. 70, datë 17.10.2019);
- Në funksion të interpretimit të nenit 287 të K.Penal, gjyqtarja i referohet Konventës së Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi (vendimi nr.70, datë 17.10.2019);
- Gjyqtarja, në kualifikimin e faktit penal, interpreton nenin 283/a/2 të K.Penal dhe citon edhe vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3/2011, si dhe nenin 3/3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope, në analizimin edhe të ekzistencës së rrethanës cilësuese të bashkëpunimit në rastin konkret (vendimi nr. 66, datë 10.10.2019);
- Në argumentimin e mendimit të pakicës, gjyqtarja thekson se Gjykata për Krime të Rënda nuk është kompetente nga pikëpamja lëndore për të shqyrtuar çështjen, e për pasojë, duhet të shpallet moskompetenca e saj. Gjyqtarja mbështetet jo vetëm në interpretimin logjik dhe literal të dispozitave procedurale të ndryshuara me ligjin 35/2017, por njëkohësisht, u referohet edhe vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë (vendimi nr. 6, datë 17.02.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë). Konkretisht, gjyqtarja argumenton se përsa kohë ekzistojnë dy qëndrime të kundërta, vendime njësuës të Kolegjit Penal (me të njëjtin kuorum) bazuar në parimin “*Ubi lex voluit dixit, ubi noluit tacuit – aty ku ligji ka dashur ka folur, atje ku nuk ka dashur, ka heshtur*”, ka vlerësuar që të zbatohë orientimin e parë të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar se nëpërmjet pikës 1 të nenit 285 të ligjit 35/2017, ligjvënësi ka shprehur vullnetin që pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve procedurale penale, të ndryshojë edhe kompetenca lëndore e Gjykatës për Krime të Rënda.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “*aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes*” vlerësohet “*shumë e lartë*”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

## **1.B Arsyetimi ligjor**

### ***1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.***



Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet përfundimtare, në përgjithësi është e thjeshtë dhe e kuptueshme, por nga ana tjetër, evidentohet se gjyqtarja në arsyetimin e vendimeve përdor shpesh edhe terma akademikë, figura letrare, apo terma latinë, që mund të mos jenë lehtësisht të kuptueshëm nga mosnjohësit e ligjit.

Në përdorimin e instituteve, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim penal, gjyqtarja përdor shpesh termat latinë, por jo gjithmonë sqaron kuptimin e tyre (*no reformatio in peius* – mosrëndim i pozitës së të pandehurit; *nullum crimen nulla poena* - të përcaktojë një krim dhe të përshkruajë një dënim; *tempus regit actum* - zbatimi i ligjit procedural në kohën e gjykimit; *tantum devolutum quantum appellatum* – shqyrtimi i çështjes në apel brenda shkaqeve të ngritura në ankim; *Ubi lex voluit dixit, ubi noluit tacuit* - ku ligji ka dashur ka folur, atje ku nuk ka dashur, ka heshtur), etj. Vendimi gjyqësor duhet të jetë i kuptueshëm si për palët, në mënyrë që të jenë në gjendje të perceptojnë situatën juridike në të cilën ndodhen pas vendimit, ashtu edhe për publikun që nuk posedon njohuri të posaçme juridike. Gjyqtarja duhet që gjithmonë të shoqërojë termat profesionalë me kuptimin e tyre në gjuhën shqipe, me qëllim që vendimi të bëhet i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit.

Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimin e fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Gjyqtarja përdor të gjitha shkronjat e alfabetit shqip, në mënyrë të veçantë konstatohet se në të gjitha vendimet gjyqësore përdor (ë dhe ç), përdor shenjat e pikësimit, thonjëzat dhe simbole të tjera. Po kështu, evidentohet se gjyqtarja përdor edhe simbole për të zëvendësuar fjalë apo lidhëza të gjuhës shqipe si për shembull: “&” në vend të “dhe”, “§” në vend të “paragrafi”.

Termet teknikë janë përdorur në mënyrë korrekte, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjin e posaçëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme dhe të ndryshme nga ajo juridike. Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, si dhe paragrafët e vendimit me njëri-tjetrin.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

### ***1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në vendimet gjyqësore penale që i nënshtrohen kësaj analize, gjyqtarja ndjek në hartimin e tyre një strukturë të qartë, të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja përfshin prezantimin e fakteve, identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjen e tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtarja ka një metodologji të qartë, sipas pjesëve përbërëse të vendimit, ku në mënyrë të posaçme konstatohet se gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë pjesës përshkruese-arsyetuese, duke e ndarë pothuajse në të gjithë vendimet në tre nëndarje të tjera, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit. Vendimet gjyqësore përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin. Në pjesën hyrëse gjejmë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces. Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në tre nëndarje, ku në mënyrë të detajuar analizon: (i) rrethanat procedurale, për të vijuar më pas me (ii) rrethanat e fakteve të çështjes, siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi, (iii) vlerësimi i gjykatës, ku merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij me faktet konkrete, duke iu referuar në mënyrë specifike shkaqeve të ankimit të palëve, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionin e saj. Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit.

Në vendimin nr. 200, datë 27.03.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë, për shkak të disponibilitetit të palës mbi ankimin, gjyqtarja në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit ndalet fillimisht tek disponimi i shkallës së parë, mbi të cilin ka ushtruar ankim pala ankuese, kërkesën e parashtruar si me shkrim, ashtu edhe në seancë, nga ankuesi, mbi heqjen dorë nga ankimi, dispozitat ligjore procedurale civile në lidhje me zgjidhjen e çështjes dhe konkluzioni i arritur nga ana e gjykatës në referim të ligjit procedural dhe të drejtës për të hequr dorë nga ankimi i palës ankuese.

Në dy procesverbalet përmbledhës të motiveve kundërshtuese për vendimet nr. 14, datë 13.02.2019, dhe vendimit nr. 15, datë 15.02.2019, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, evidentohet se gjyqtarja fillimisht parashtron se në të do të paraqesë “Motivet kundër” vendimit të dhënë prej kolegjit. Gjyqtarja vijon duke parashtruar konkluzionin e saj për cilësimin juridik të fakteve në çështjen objekt gjykimi dhe në mbështetje të tij, merr në analizë ligjin material të zbatueshëm, për të verifikuar më pas zbatimin e tij në faktet e çështjes. Në përfundim, gjyqtarja merr në analizë ligjin procedural të zbatueshëm dhe në zbatim të tij, konkludon për disponimin përfundimtar që duhet të kishte dhënë gjykata.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.*

### **1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe vendimeve gjyqësore të analizuar, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtares për provueshmërinë e fakteve konkrete.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike, duke u dhënë zgjidhje në mënyrë shteruese të gjitha pretendimeve të palëve në ankim, dhe duke u ndaluar në interpretimin e ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete, si dhe lidhjen shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura nga gjyqtarja lidhur me kërkimet konkrete. Kjo analizë e integruar rezulton veçanërisht në disa vendime, si më poshtë:

- Në kuadër të përcaktimit nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, gjyqtarja nuk ndalet vetëm në trajtimin teorik të interpretimit të dispozitave procedurale përkatëse (nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale), por i analizon ato në përputhje me provat dhe rrethanat e çështjes deri në këtë fazë procedurale. Gjatë kësaj analize, gjyqtarja ndalet në mënyrë shteruese tek papërshtatshmëria e një mase sigurimi më të favorshme për personin nën hetim (referuar shkakut të ankimit për ndryshimin e masës së sigurimit), pasi hetimi në gjendje të lirë ndaj të hetuarit apo një masë tjetër e ndryshme nga ajo e arrestit në burg nuk mund të jetë e aftë që të pengojë vazhdimin e veprimtarisë së tij kriminale, mund të cedojë në ndalimin e tij që të ndërpresë kontaktet me subjektet e tjerë me të cilët mund të ketë kryer krimet, apo mund të vërë në rrezik qoftë marrjen e provave të tjera, apo vërtetësinë e tyre. Në mospranimin e shkaqeve të ankimit, gjyqtarja e vë theksin në mënyrë të veçantë tek rëndësia e fakteve dhe bashkëpunimi i të hetuarit në kryerjen e veprave penale për të cilat ai dyshohet se ka kryer. Gjatë interpretimit dhe arsyetimit ligjor të bërë nga ana e gjyqtares mbi ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të masës së sigurimit ndaj personit në hetim, referuar edhe shkaqeve të ankimit (në lidhje me papërshtatshmërinë e masës së sigurimit ndaj tij), gjyqtarja konkludon se nuk cenohen në rastin konkret parimet e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë, në lidhje me caktimin e masave të sigurimit të përcaktuara nga ligjvënësi në nenin 229 të K.Pr.Penale. Gjyqtarja arrin në këtë konkluzion duke iu referuar rrezikshmërisë së veprave penale për të cilat dyshohet personi nën hetim, apo edhe referuar rrezikshmërisë dhe personalitetit të autorit të dyshuar. Konstatohet se gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë analizimit dhe dhënies zgjidhje të gjitha pretendimeve dhe shkaqeve të ankimit në mënyrë shteruese, duke konkluduar se nuk evidentohet asnjë shkak i ndryshimit të masës së sigurimit në favor të të

hetuarit dhe po kështu, nuk ekziston as ndonjë shkak i padënueshmërisë së tij, apo shuarje e veprave penale që i atribuohen (*vendimi nr. 57, datë 08.10.2019*);

- Referuar shkaqeve të ankimit të të pandehurit, në analizën që i bën pretendimeve të mbrojtjes dhe provave objekt kontestimi, gjyqtarja vlerëson se ato janë të plota, bindëse, të sakta dhe të përputhura me njëra tjetrën dhe që nuk kundërshtojnë të tjera prova të drejtpërdrejta apo të tërthorta ose indicie dhe se është plotësisht i bazuar në ligj dhe në prova nxjerrja e faktit se është i pandehuri personi që ka përdorur numrin e telefonit gjatë veprimtarisë kriminale. Në analizën e provueshmërisë së ekzistencës së faktit penal dhe përgjegjësisë penale të të pandehurit referuar shqyrtimit të çdo prove, gjyqtarja përcakton dhe identifikon edhe rolin e të pandehurit në kryerjen e këtyre veprave penale, në formën e veçantë të bashkëpunimit. Po kështu, në rrëzimin e shkaqeve të të pandehurit të ngritur në ankim, gjyqtarja ndalet dhe sqaron edhe kuptimin e provës kundërshtuese të pretenduar nga mbrojtja, e që në rastin konkret prova së cilës i referohet mbrojtja nuk është e aftë që të mohojë faktin penal që i atribuohet të pandehurit. Referuar interpretimit të dispozitave materiale penale dhe ligjit të posaçëm, referuar edhe shkaqeve të ankimit, gjyqtarja analizon elementet e kësaj vepre penale (*nenit 257/a/2 i K.Penal*) për të arritur në cilësimin e drejtë juridik të bërë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe përgjegjësisë penale të të pandehurit, në rastin konkret, si subjekt i posaçëm. Për t'i dhënë përgjigje ankimit të të pandehurit në lidhje me mosekzistencën e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprave penale, pasi kjo pasuri është krijuar para faktit penal të kontestuar, gjyqtarja e orienton analizën e saj drejt përputhshmërisë së sjelljes për të penguar identifikimin e prejardhjes kriminale të pasurisë, në prani të së cilës synimi konkret i fitimit mund të vlejë për të forcuar, e jo për të përjashtuar, dashjen për të pastruar produktet e veprës penale. Referuar shkaqeve të ankimit të të pandehurit, gjyqtarja analizon arsyet se përse ky shkak nuk duhet të pranohet, duke analizuar në mënyrë specifike rrethanat që ndikojnë në individualizimin e dënimit në rastin konkret (*neni 47 i K.Penal*), rrethana që nuk justifikojnë ulje të mëtejshme të dënimit. (*vendimi nr. 70, datë 17.10.2019*);
- Në arritjen e konkluzionit se ndaj disponimit të gjykatës së shkallës së parë për marrjen e kampionëve biologjikë nuk lejohet ankim, gjyqtarja mbështetet në interpretimin literal dhe krahasues të dispozitave procedurale penale, si në lidhje me llojet e disponimeve të gjykatës (*urdhra dhe vendime*), ashtu edhe për rastet kur parashikohet e drejta e ankimit (*në mënyrë eksplicite apo jo*), (*vendimi nr. 222, datë 06.12.2019*);
- analizën ligjore të nenit 28 të K. Penal, ku evidenton elementët e nevojshëm të tij, për t'i verifikuar më pas në faktet e çështjes objekt gjykimi. Gjyqtarja merr në analizë ligjin procedural të zbatueshëm, si dhe parimin "*no reformatio in peius*". Në përfundim të analizës, gjyqtarja konkludon për disponimin përfundimtar që duhet të kishte dhënë Gjykata. (*vendimi i pakicës në vendimin nr. 14, datë 13.02.2019*);
- Analizon rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në individualizimin e dënimit për secilin nga të pandehurit në rastin konkret (*nenet 47, 48 dhe 49 të K.Penal*), rrethana që nuk justifikojnë ulje të mëtejshme të dënimit. (*vendimi nr. 66, datë 10.10.2019*);
- Gjyqtarja e mbështet analizën juridike në funksion të argumentimit se Gjykata e Krimeve të Rënda nuk është një gjykatë kompetente për shqyrtimin e çështjes për veprat penale për të cilën akuzohen të pandehurit (*nenet 128/a, 114 dhe 113 të K.Penal*), duke aplikuar të gjitha parimet e së drejtës dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, asaj Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së. Gjyqtarja thekson se pas hyrjes në fuqi të ligjit 35/2017, këto vepra nuk janë më në kompetencën lëndore të parashikuar nga neni 75/a i K.Pr.Penale, pasi ligjvënësi

nëpërmjet parashikimit të nenit 74 të K.Pr.Penale të ndryshuar, vendosi që kompetenca lëndore për gjykimin e këtyre kategorive të veprave penale t'i caktohet rrethëve gjyqësore dhe nuk parashikoi nëpërmjet përdorimit të dispozitës kalimtare që veprat penale të sipërcituara të mbeteshin në kompetencën e Gjykatës për Krime të Rënda, deri në krijimin e Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*mendimi i pakicës në vendimin nr. 15, datë 15.02.2019*);

- Gjyqtarja analizon elementet e figurës së veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i K.Penal, duke interpretuar dispozitat materiale në ligjin e posaçëm (*Kodi Rrugor*) (*vendimi nr. 160, datë 10.04.2019*).

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse, në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u parashtruar në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsyetimit dhe më pas duke u marrë në analizë lidhur me bazueshmërinë ose jo të tyre, në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimin konkret. Duke u marrë në shqyrtim dhe duke analizuar jo në një pjesë të veçuar të arsyetimit, por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, pretendimet e palëve marrin një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose në prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme, si pjesë e arsyetimit të vendimit.

Në tërësi, në të gjitha vendimet e gjyqtares, analiza ligjore, si në lidhje me aspekte procedurale të zhvillimit të gjykimin, mënyrën e marrjes së provave apo vlerësimin e atyre, ashtu edhe në analizën ligjore të veprës penale ose objektit të kërkesës penale në shqyrtim, zhvillohet e plotë, e thellë, gjithëpërfshirëse dhe shteruese. Analiza përmbush në çdo rast jo vetëm standardet e procesit të rregullt ligjor, por pasurohet edhe me qëndrime të praktikës gjyqësore, të cilat duket se janë në vëmendje të veçantë të gjyqtares, duke u integruar në mënyrë të natyrshme dhe në masën e duhur në arsyetim. Kjo mënyrë arsyetimi i jep vlerë të shtuar dhe cilësi të larta analizës dhe argumentimit të vendimeve. Vlerë e shtuar e cilësisë së arsyetimit të vendimeve gjyqësore është edhe referimi dhe interpretimi i normave të akteve të së drejtës ndërkombëtare, të cilat gjyqtarja duket se i ka patur në vëmendje në çdo rast, për të mbështetur interpretimin mbi kuptimin e dispozitave të ndryshme të legjislacionit vendas, apo për të vlerësuar nëse legjislacioni i brendshëm përputhet me standardet e vendosura nga aktet e së drejtës ndërkombëtare.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit  
KRITERI  
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2.A Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë.

#### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 29 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin dy kategorive, kategorisë së çështjeve “kërkesa penale të hetimit paraprak” dhe kategorisë “kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”. Duke iu referuar objektit të çështjeve të pasqyruara në tabelat me të dhëna statistikore, rezulton se kërkesat janë: me objekt “Ankimi kundër masave të sigurimit”, për të cilat neni 249 paragrafi i pestë i K.Pr.Penale,<sup>2</sup> parashikon se duhet të shqyrtohen brenda 10 ditëve nga marrja e akteve; me objekt “ankim ndaj mosfillimit të procedimit penal”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 291 pika 5 të K.Pr.Penale,<sup>3</sup> duhet të shqyrtohen nga gjykata brenda 30 ditëve nga marrja e akteve; me objekt “shtyrje e ekzekutimit të vendimit”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 476 pika 3 të K.Pr.Penale,<sup>4</sup> duhet të shqyrtohen brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve; me objekt “zgjatje e afatit të

<sup>2</sup> Neni 249 pika 5 i K.Pr.Penale parashikon se: “Ankimi shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve”.

<sup>3</sup> Neni 291 pika 5 i K.Pr.Penale parashikon se: “Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve. Gjykata e apelit vendos brenda 30 ditëve nga marrja e akteve”.

<sup>4</sup> Neni 476 pika 3 i K.Pr.Penale parashikon se “Gjykata arsyeton vendimin brenda 5 ditëve. Kundër vendimit lejohet ankim brenda 5 ditëve. Gjykata e apelit vendos mbi ankimin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve”.

*paraburgimit*”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 249 pika 10 të K.Pr.Penale,<sup>5</sup> shqyrtohet brenda 15 ditëve nga marrja e akteve, si dhe me objekt *“rivendosje në afat të ankimit”*, të cilat sipas parashikimeve të nenit 420 pika 8 të K.Pr.Penale,<sup>6</sup> shqyrtohet brenda 15 ditëve nga marrja e akteve.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se nga 29 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi,<sup>7</sup> vetëm 1 (një) prej tyre është shqyrtuar në tejkallim të këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor (1 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (29 çështje), gjyqtarja rezultojnë që të ketë gjykuar 3.44% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës parashtrajnë se sipas të dhënave statistikore, evidentohet qartazi se janë respektuar të gjitha afatet procedurale të parashikuara nga ligji.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është *“0-10 %”*, duke u pikëzuar me 15 pikë.

#### **2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezultojnë se gjyqtarja ka gjykuar në total 24 (njëzet e katër)<sup>8</sup> çështje në cilësinë e relatores, nga të cilat 12 (dymbëdhjetë)<sup>9</sup> çështje penale të kategorisë *“krime”*, 2 (dy)<sup>10</sup> çështje të kategorisë *“civile me palë kundërshtare”*, 9 (nëntë) çështje të kategorisë *“kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake”* dhe 1 (një) çështje të kategorisë *“kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”*, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së, përcakton këto standarde minimal kohore: jo më tej se 9 muaj për gjykimet penale në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda; jo më tej se 9 muaj kur procedohet

<sup>5</sup> Neni 249 pika 10 i K.Pr.Penale parashikon se *“Gjykata e Apelit vendos brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve”*.

<sup>6</sup> Neni 420 pika 8 i K.Pr.Penale parashikon se *“Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 15 ditëve nga data e marrjes së akteve”*.

<sup>7</sup> Në Tabelën nr. 46 çështjet me numër rendor 1-13,15, 16, 19, 21, 23,24, 25, 27, 28, 29, 31, 32, 34, 36, 37 dhe në Tabelën nr. 48 me numër rendor 1.

<sup>8</sup> Pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen afate ligjore gjykimi.

<sup>9</sup> 11 çështje të përfunduara pranë Gjykatës së Apelit të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 1 çështje të përfunduar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

<sup>10</sup> 1 çështje përfunduar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë dhe 1 çështje përfunduar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim, si dhe jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave penale.

Sa më sipër, rezulton se nga të gjitha çështjet e përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, asnjë prej tyre nuk është gjykuar jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “0-10 %”, duke u pikëzuar me 5 pikë.*

### **2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.**

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për të gjitha kategoritë e çështjeve. Konkretisht,

Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 9 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Krime”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 71.25 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “civile me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 21 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, është 28 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke u pikëzuar me 5 pikë.*

### **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.**



Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara (53 çështje), me numrin e çështjeve të caktuara (51 çështje) brenda vitit kalendarik, është 103.9 %.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “+99%”, duke u pikëzuar me 10 pikë.*

### **2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- Për çështje të kategorisë “krime”, koha mesatare e arsytimit është 20.5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 430/1, paragrafi 4, i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është 8.7 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 249/6 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është 13.07 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 paragrafi 4 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është 10 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 paragrafi 4 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “civile me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 16 ditë, për të cilën nuk rezulton që të jetë parashikuar një afat ligjor për arsytimin e vendimit, e në këtë kontekst, rezulton të jetë më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 20 ditë, i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke u pikëzuar me 15 pikë.*

### **2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.**

**2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.**

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe Raportit Analitik, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përfshiruar ato pa palë kundërshtare, për

kategorinë “krime” është 4.5 seanca, për kategorinë “civile me pale kundërshtare” është 2 seanca.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezultojnë se:

- Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët;
- Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues, rezultojnë se seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë shumë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit. Në të gjitha rastet e tjera, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, të tilla si: për t’u paraqitur mbrojtësit e të pandehurit me qëllim garantimin e mbrojtjes, për t’u njoftuar në mënyrë efektive viktimat, konform nenit 58/1, shkronja “ë”, të K.Pr.Penale; për shpalljen e vendimit të arsyetuar, sipas parashikimeve të nenit 379 të K.Pr.Penale, etj.;
- Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, të parashikuara në nenin 342/2 të K.Pr.Penale.

Konstatohet se pavarësisht numrit të seancave në çështjet e kategorisë “krime”, nga ana e gjyqtarës janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të zhvilluar dhe përfunduar procesin në kohë, si dhe janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme për zhvillimin e seancave efektive. Shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjykatës, por në funksion të shqyrtimit të çështjeve, konform një procesi të rregullt ligjor, në mënyrë që afati i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve të mos bëhet shkak për cenimin e të drejtave procedurale të palëve në proces.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive” aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është e shkallës së lartë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore në dosjet e analizuar nuk vjen për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarës, duke u pikëzuar me 15 pikë.*

## **2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.**

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezultojnë se gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke proceduar me nxjerrjen e aktit proceduralë “Urdhër –Thirrje”, duke respektuar afatin procedural 10 ditor të parashikuar nga neni 426/1 i Kodit të Procedurës Penale. Vetëm në dosjen me nr. 222 vendimi, datë 06.12.2019, të Gjykatës së Apelit Për Krime të Rënda, nuk rezultojnë që të jetë nxjerrë urdhër për kalimin e çështjes në seancë

gjqësore, për shkak të faktit se kjo çështje është shqyrtuar nga trupi gjykues në dhomë këshillimi, mbi bazën e ankimit të bërë nga personi nën hetim.

Seancat gjyqësore rezultojnë të jenë planifikuar dhe zhvilluar brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me sistemin e regjistrimit FTR audio, si dhe janë pasqyruar në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal, sipas parashikimeve të neneve 426/a e vijues të K.Pr.Penale. Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për relativimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relativimin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, shpalljen e trupit gjykues, deklarimin e hapur të diskutimit, relativimin nga kryetari i trupit gjykues në mënyrë të përmbledhur të dosjes gjyqësore dhe shkaqeve të ngritura në ankim, parashtrimin e pretendimeve nga palët, dhënien fund shqyrtimit gjyqësor dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancave është zhvilluar në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë përgjithësisht të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes (*në rastet e disponimit për kërkesat e palëve, përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, shtyrjen e seancës, etj.*).

Në rastet kur është marrë vendim i ndërmjetëm në lidhje me pezullimin e afateve të paraburgimit, gjyqtarja ka zbardhur të arsyetuar vendimin gjyqësor, duke e bërë pjesë të dosjes (*nr. 66 vendimi, datë 10.10.2019; nr. 14 vendimi, datë 413.02.2019*).

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesë të papërfillshme, shoqëruar me relativimin e shkakut që ka shkaktuar vonesën në çeljen e seancës, por nuk rezulton që seancat të mos jenë zhvilluar për shkak të kësaj vonese.

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

## **2.C Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore.**

## ***2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.***

Nga vëzhgimi i dosjeve të 6 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë të renditura në mënyrë të rregullt, duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik (sipas kategorive të akteve) dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 6 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme, duke përmbajtur aktin e shortit, urdhër-thirrjen për paraqitjen e palëve në seancën gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, aktet e dorëzuara nga palët (*kërkesë për shtyrje të seancës gjyqësore, kërkesë për heqje dorë nga ankimi*), konkluzionet e paraqitura nga prokurori, pretendimet e mbrojtjes, procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, vendimin përfundimtar të gjykatës, si dhe CD-në e regjistrimit audio të seancave gjyqësore.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

## ***2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*kërkesat për shtyrje të seancës gjyqësore, kërkesat për heqje dorë nga ankimi, konkluzionet e prokurorit, pretendimet e mbrojtjes*), aktet e hartuara nga gjykata (*urdhër-thirrje, njoftimet për palët, procesverbalet e çdo seance, vendimet përfundimtare dhe ato të ndërmjetme kur ato janë zbardhur me vete, vendimet për pezullimin e afateve të paraburgimit*).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

### **3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE**

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### **3.A Etika në punë**

##### **3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtaren {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit viti 2019, ndaj gjyqtares rezulton të jenë paraqitur tre ankesa, dy prej të cilave janë bashkuar, për shkak se ankesat janë të të njëjtit ankues, drejtohen ndaj të njëjtës magjistrate, si dhe pretendohen të njëjtat shkelje. Pas verifikimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.763/3 Prot., datë 06.11.2020 dhe nr.1144/3 Prot., datë 28.12.2020,<sup>11</sup> ka vendosur arkivimin e tyre pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultateve të verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

Ankesa e shtetasit V.Ç., depozituar në KLGJ me nr. 344 Prot., datë 22.01.2019, regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr. 763 Prot., datë 01.06.2020, konsiston në pretendimet që kanë të bëjnë me zgjidhjen e çështjes në themel. Lidhur me këtë ankesë, ILD ka vendosur arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar, me vendimin nr. 763/3 Prot., datë 06.11.2020 duke arsyetuar se: “Për rrjedhojë pretendimet e ankuesit nuk janë të natyrës që përbëjnë shkelje disiplinore sipas përcaktimeve të 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar duke mos u plotësuar kushti për

<sup>11</sup> Vendimet për verifikimin e ankesave janë dërguar nga ILD me shkresat me nr. 1807/2 Prot., datë 17.08.2020 dhe nr. 2437/23 Prot., datë 30.12.2020 dhe i përkasin ankesave të shtetasve V.Ç dhe E.Sh.

*pranueshmëri të ankesave të parashikuara nga neni 120/1 shkronjat “d”, “dh”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorive në Republikën e Shqipërie”, i ndryshuar. Në ankesat e paraqitura mungojnë dyshime të arsyeshme, të cilat justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj tyre për ndonjë shkelje disiplinore konkrete”.*

Ankesa e dytë është paraqitur nga shtetasi E.Sh., pranë KLGJ me nr. 2700 Prot., datë 14.05.2019, përcjellë pranë Zyrës së ILD me nr. 1144 Prot., datë 15.06.2020.

Ankesa e tretë është depozituar nga shtetasi E.Sh., G.D., E.Z. dhe B.Sh., dorëzuar pranë KLGJ-së me nr. 2700/1 Prot., datë 13.06.2019 dhe regjistruar pranë ILD-së me nr. 1225 Prot., datë 17.06.2020.

Për shkak se ankesat janë të të njëjtit ankues, drejtohen ndaj të njëjtës magjistrate, si dhe pretendohen të njëjtat shkelje, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është vendosur bashkimi i tyre dhe trajtimi i përbashkët në të njëjtin akt. Ankuesi ngre pretendime ndaj gjyqtarës Sadia {...}, në cilësinë e Zv. Kryetares së Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (sot Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar) për kryerjen e disa shkeljeve procedurale që lidhen kryesisht me rregullshmërinë e hedhjes së shortit, marrjen pa short të cilësisë së relatores, kryerjen e shkeljeve në trajtimin joligjor të kërkesave për dorëheqje të gjyqtarëve, shkelje dhe imponim të kundërligjshëm në procedurën e caktimit të gjyqtarëve për shqyrtimin e kërkesave për përjashtim, shkelje për keqadministrim të procesit dhe krijim të mosmarrëveshjeve me natyrë personale me të pandehurit. Lidhur me këto pretendime, me vendimin nr.1144/3 Prot., datë 28.12.2020, ILD ka vendosur arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar, duke arsyetuar se: *“Shkaqet e pretenduara në ankesat e ankuesve vlerësohet se nuk përbëjnë shkak për fillimin e hetimit disiplinor nga ana e gjyqtarës {...}, për ndonjë prej shkeljeve të parashikuara në nenet 102,103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për sa më sipër, vlerësohet se ankesat e ankuesve E.Sh., G.D., E.Z., dhe B.Sh., referuar natyrës së pretendimeve të parashtruara, nuk plotësojnë kushtet e pranueshmërisë të parashikuar nga neni 120, pika 1 shkronjat d) dhe dh) të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorive në Republikën e Shqipërie”, i ndryshuar”.*

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarës në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojnë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 35 pikë.

### **3.B Integriteti i gjyqtarit**

#### ***3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD-së tre ankesa, trajtuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.763/3 Prot., datë 06.11.2020 dhe nr.1144/3 Prot., datë 28.12.2020, me të cilët është vendosur arkivimi i ankesave, pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se nuk plotësojnë kushtet e pranueshmërisë, për shkaqet e referuar në analizën e mësipërme.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtares {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr.193/24 Prot., datë 29.06.2020, konkludohet se *deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjtetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjtetin e gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjteti” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 40 pikë.

### **3.C Paanësia e gjyqtares**

#### ***3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares dhe vlerësimi i kryetarit të gjykatës.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

#### ***3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2019–31.12.2019, është paraqitur 1 (një) kërkesë për përjashtimin e gjyqtares, por kjo kërkesë është rrëzuar. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtarja ka paraqitur 6 (gjashtë) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 4 (katër) janë pranuar dhe 2 (dy) janë rrëzuar.

Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”, duke qenë se nuk rezulton asnjë kërkesë e paraqitur dhe pranuar për përjashtimin e saj nga gjykimi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”.



Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

#### 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### 4.A Aftësia e komunikimit.

##### 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces përdor në përgjithësi fjalë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta, por nga ana tjetër konstatohet se gjyqtarja në arsyetimin e vendimeve përdor shpesh edhe terma akademikë, figura letrare, apo terma latinë. I njëjti konstatim rezultojnë edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu edhe regjistrimet e seancave në sistemin audio.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarës në nivel shumë të lartë.

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezultojnë se gjyqtarja në çdo rast komunikojnë në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

##### 4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

#### **4.B Aftësia për të bashkëpunuar.**

***4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale, përfshirjen në diskutime ligjore, organizimin e punës në gjykatë dhe komunikimin brenda trupave gjyqësore.

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

#### **4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim korrekt me personelin e gjykatës, ku përgjatë harkut kohor 9 prill 2019 deri në 18 Dhjetor 2019, ka kryer edhe funksionin e Zv. Kryetares, duke krijuar kështu një ambient pune harmonik dhe produktiv.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.**

##### **4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e ekspertës në 4 aktivitete trajnuese, gjithsej 5 ditë dhe në cilësinë e pjesëmarrëses në 1 (një) aktivitet trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 1 ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9<sup>12</sup> të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e ekspertit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, duke u përlllogaritur 1 ditë pjesëmarrje si eksperte, e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrëse. Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë gjatë periudhës një vjeçare të vlerësimit në 5 aktivitete trajnuese, të cilat përbëjnë 13.5 ditë trajnimi.

Sipas parashikimeve të nenit 5 pika 3 të Ligjit për Statusin *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.* Në rastin konkret gjyqtarja ka marrë pjesë në 5 aktivitete trajnuese të shtrira në 13.5 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimalë (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e saj dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së saj, pasi rezultojnë të jenë aktivitete me tema të së drejtës penale dhe procedurale penale.

---

<sup>12</sup>Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

*Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.*

***Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime është nga 5-40 ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2019) duke u pikëzuar me 20 pikë.

#### ***4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se gjyqtarja {...}, përgjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, ka marrë pjesë në 4 (katër) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertes, aktivitete të zhvilluara në datat 25 janar 2019, 8 mars 2019, 23-24 prill 2019 dhe 24 maj 2019. Nuk rezultojnë të dhëna të tjera për përfshirjen e saj në aktivitete trajnuese të organizuara nga institucione të tjera.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtar gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e ekspertes në 4 (katër) aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës së vlerësimit, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

***Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

#### ***4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjyqtarja gjatë viti 2019 është angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale që kanë pasur si qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë, apo aktivitete të tjera. Konkretisht, gjyqtarja rezultojnë të jetë angazhuar në veprimtaritë e organizuar nga KLGJ, që kanë pasur si qëllim përmirësimin e projektakteve lidhur me rregullat plotësuese për vlerësimin e gjyqtarëve dhe Metodologjinë e pikëzimit.

Nga ana tjetër, në lidhje me këtë tregues për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-31.12.2019, rezulton se me vendimin e Këshilli të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, gjyqtarja është caktuar si Gjyqtare për Mediat në juridiksionin e Apelit për Krime të Rënda/Apelit të Posaçëm për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, duke qenë se rezultojnë të dhëna, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.*

#### **4.C.ç Publikimet ligjore akademike.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna. Për pasojë, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me zero pikë.

***Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtares dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

## NDARJA F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

*Në këtë pjesë, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5, shkronja “c” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi bazën e pikëzimit përcaktohet niveli i vlerësimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit si dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit të gjyqtarit.*

<b>Niveli i vlerësimit për çdo kriter</b>		
<b>Kriteri</b>	<b>Pikët</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
<b>Niveli i përgjithshëm i vlerësimit</b>		
Vlerësimi i përgjithshëm	395	Shkëlqyeshëm

### PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr. 96/2016, “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe të vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e saj të vazhdueshëm në aktivitetet për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.



**SHTOJCA 1**  
**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE**  
**NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}**  
**PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2019 - 31 DHJETOR 2019**

<b>1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES</b>			
<b>Treguesit</b>		<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë</b>
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
<b>B. Arsytimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
<b>2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES</b>			
<b>Tregues</b>		<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i	0-10 %



		kryetarit	
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+ 99 %
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme	1. Aktet e dosjeve të	Shumë e lartë

	procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	
<b>C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë
<b>3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>			
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Vetëvlerësimi i gjyqtares 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë
<b>C. Paanësia e gjyqtarit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm

#### 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarës 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarës 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon	Ka të dhëna

		ngritjen profesionale të gjyqtares	
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>		<b>395</b>	
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>		<b>Shkëlqye</b>	